



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### KRYETARI

---

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491*

Nr. 1111/16 Prot.

Tiranë, më 30.04.2016

## V E N D I M

Nr. 46, Datë 30.04.2016

### PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS DURRËS "MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DOGANOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE DOGANORE DHE VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE."**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e legjislacionit doganor në procesin e realizimit të të ardhurave doganore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare", për periudhën 01.01.2014-31.12.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## **A-MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Nga auditimi i ushtruar lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme dërguar me shkresën përcjellëse nr. 543/18 prot, datë 30.09.2015, u konstatua se:

**1/a.** Nuk janë nxjerr vendime administrativ për diferencën **në vlerë 53,972,393 lekë** për vitin 2012, detyrime të papaguara nga subjekti “**■** Shpk shumë e cila nuk është përfshirë në vendimin administrativ nr. 145, datë 29.01.2015, nga e cila vlera 43,559,406 lekë janë detyrime për 12 raste të konstatuara sipas aneksit nr. 4. për të cilat DDD duhet të rishqyrtojë dhe të përllogarisë detyrimet doganore mbi çmimin sipas të dhënave të disponueshme, duke aplikuar penalitet në masën 3 fish në zbatim të nenit 261.2 të Kodit Doganor.

**1/b.** Nuk është korriguar detyrimi doganor i papaguar nga subjektit “**■**” për vitin 2013, **në vlerë 10,824,655 lekë** dhe nuk është reflektuar ndryshimi i detyrimeve të konstatuara nga audituesit në 4 deklaratat e mësipërme, detyrim i cili nuk është përfshirë në vendimin nr. 145, datë 29.01.2015.

Sa më sipër, trajtuar hollësisht në faqet nr176-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës, të verifikojë, analizojë, të nxjerr vendime administrative për diferencat e krijuar gjatë vitit 2012 dhe 2013, t'i kontabilizojë ato duke marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin në kohë të detyrimeve të papaguara.

Të merren masa të plota administrative dhe ligjore, për ndërprerjen e menjëhershme të këtyre praktikave abuzive, vlerësimeve me dy standarde të vlerës doganore të artikujve “*veshje të këmbës*”, për subjektet të cilat operojnë në këtë treg, si dhe trajtimin e tyre në mënyrë të barabartë.

Për të gjitha rastet e trajtuara sa mësipër, për çdo DAV të përshkruar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përllogarithen penalitetet përkatëse në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pjesa e VIII-të.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Dega e Doganës Durrës të ngrenë një komision të veçantë i cili të verifikojë dhe të zbatojë rekomandimet e lëna nga KLSH.

### **Menjëherë**

**2.** Nga auditimi i ushtruar në DDD rezultoi se është marrë vendimi administrativ nr. 145/1, prot, datë 06.02.2015 me të cilin është vendosur pezullimi i efekteve të vendimit nr. 145, datë 29.01.2015, **me vlerë 124,953,491 lekë** të subjektit “**■**”, pa lëshuar më parë një garanci nga subjekti, për pagesat e detyrimeve në import, në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” nenet 34-37, neni 18, pika 4, neni 19 pika 1 dhe “Rregulloren e brendshme të Degëve Doganore” me nr. 19095 prot. datë 12.11.2012, neni 13 pika 4.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 176-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës të marrë masa për anulimin e vendimit administrativ nr. 145/1 prot, datë 06.02.2015 dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 145, datë 29.01.2015, **me vlerë 124,953,491 lekë** të subjektit “**■**”.

### **Menjëherë**

**3.** Dega e Doganës Durrës në zbatim të rekomandimeve të KLSH, për vitin 2015 ka nxjerrë vendimet nr. 337 dhe 338, datë 18.04.2016, në vlerën 44,007 mijë lekë, për subjektin “**■**”. Bazuar në këto vendime, KLSH vlerëson maksimalisht integritetin e Drejtorit të Degës së Doganës Durrës zj. E.C.

**4.** *Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe procedurave të ndjekura në deklarinë e mallrave, rezultuan fenomene të trajtimit me origjinë preferenciale të artikujve me deklarata faturë vlera e të cilëve e kalon 6000 euro, në shkelje të legjislacionit doganor me pasojë shmangien e detyrimeve doganore të cilat kanë ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave, ndër të cilët një nga faktorët kryesor është mungesa e aksesit të nevojshëm teknik në sistemin “ASYCUDA World” për punën e Zyrës së Kontrollit Aposterior referuar detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 14 pika 4 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore Nr. 19095/2Prot, datë 12.11.2012 me qëllim bërjen të mundur të efikasitetit të kontrollit dhe konstatimin e shkeljeve përkatëse.*

*Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa për një analizë të thelluar të faktorëve që kanë ndikuar në krijimin e këtyre fenomeneve, analizë që do të shërbejë si bazë më pas për nxjerrjen e përgjegjësiive për mungesën e aksesit të nevojshëm teknik në sistemin “ASYCUDA World” për punën e Zyrës së Kontrollit Aposterior me qëllim bërjen të mundur të efikasitetit të kontrollit dhe konstatimin e shkeljeve përkatëse.

**5.** *Nga auditimi rezulton se të ardhurat doganore në total nuk janë realizuar në vlerë **2,099,726 mijë lekë** ose 4 % më pak se sa programimi i vitit 2015. Peshën kryesore në të ardhurat e degës doganore, si në programim ashtu dhe realizim e zënë të ardhurat nga TVSh, e cila është realizuar në masën 96,5 %. Me tejkalim paraqiten, zëri i rentës minerare me 46,220 mijë lekë ose 8,5 % më shumë se programimi, taksat doganore me 24,874 mijë lekë ose 2 % më shumë. Realizimi i të ardhurave doganore në masën 96 %, tregon për një punë të pamjaftueshme të autoritetit doganor veçanërisht në drejtim të realizimit të zërave kryesor të të ardhurave kryesisht të ardhurave nga TVSH dhe nga akciza të cilat për periudhën në auditim janë realizuar në masën 96, 5 % dhe 94,5%.*

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 22-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa për të kryer një analizë të thelluar të

faktorëve që kanë ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave, analizë e cila do të shërbejë si bazë në të ardhmen, për një programim të saktë të ardhurave sipas zërave shoqëruar me një nivel programimi të studiuar dhe me një drejtim efektiv të personelit doganor, me qëllim arritjen e të gjitha objektivave objektivave në fushën e realizimit të ardhurave.

### **Në vijimësi**

**6.** *Nga auditimi i ushtruar në Sektorin e Regjimeve dhe të Akcizës lidhur me zbatimin e legjislacionit dhe procedurave doganor gjatë administrimit të Regjimit të Përpunimit Aktiv, për vitin 2015 u konstatua se ky Sektorë nuk ka administruar një Program Vjetor Kontrolli, në përputhje me analizën vjetore të riskut të miratuar nga autoriteti doganor kompetent, për ushtrimin e kontrolleve dhe kryerjen e inventarëve vjetore me grupe pune të posaçme në ambientet e subjekteve që operojnë në këtë regjim. Numri i kontrolleve të realizuara gjatë vitit 2015 ka qenë shumë i ulët në raport me numrin e madh të subjekteve që operojnë me këto regjime, pasi konstatohet një mungesë e theksuar e burimeve njerëzore të punësuar në Sektorin e Regjimeve dhe të Akcizës, por edhe për arsye të shtrirjes territoriale, veprim ky që bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor” nenet 11 dhe 23.*

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 138-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës të hartojë Programe Vjetore Kontrolli, me synim arritjen e konkluzioneve të besueshme që të tregojnë se sa ata janë në dijeni dhe se i administrojnë të gjitha burimet e hyrje daljeve nga dhe në ambiente e liçensuara të përpunimit doganor të lëndëve të para apo ndihmëse për prodhimin e produkteve të gatshme, duke mos lenë mënjanë inventarizim e përgjithshëm vjetor, të aktivitetit.

### **Në vijimësi**

**7.** *Nga auditimi i ushtruar për administrimin dhe rikuperimin e borxhit doganor u konstatua se ai ka arritur në vlerë 1,407,968 mijë lekë, me 511 raste dhe për 438 subjekte debitorë, ndërkohë që masat për rikuperimin e tij kanë rezultuar jo efektive, mbasi për asnjë subjekt debitor nuk është zbatuar masa e sekuestrimit për të mbuluar detyrimet debitorë, veprim që bie ndesh me kërkesat e Kodit Doganor i ndryshuar neni 245, si dhe kërkesat e udhëzimit nr. 6 protokolluar në doganë me nr. 11569/2, datë 23.07.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe akcizës”.*

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 138-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrin masat konkrete në përputhje me legjislacionin në fuqi, si me obligimet reciproke të përcaktuara në marrëveshjen e përbashkët të

nënshkruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në kuadrin e marrëveshjeve ekzistuese apo nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja dhe me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor.

#### *Në vijimësi*

**8.** Nga auditimi i raporteve lidhur me kontrollet e ushtruara nga Sektori i Regjimeve dhe i Akcizës, në subjektet e akcizës, u konstatua se kontrollet nuk janë të plotë, pasi nuk pasqyrojnë kontrollin e përgjithshëm të aktivitetit, si në mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit, kryerjen e Inventarizimeve të lëndëve të para, produkteve të akcizës, inventarin e gjendjes së mallrave në depozitat e licensuara, inventarin e ambienteve të prodhimit, si dhe ndërtesat ose AQT (aktivet e qëndrueshme të trupëzuara), inventarin e pullave fiskale, mjeteve të transportit, si dhe kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSh”, i ndryshuar neni 45, pika 1. Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 201-213 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës të hartojë Programe Vjetore Kontrolli, me synim arritjen e konkluzioneve të besueshme që të tregojnë se sa ata janë në dijeni dhe se i administrojnë të gjitha burimet e hyrje daljeve nga dhe në ambiente e licensuara të prodhimit të artikujve që trajtohen me akcizë, duke mos lenë në haresë inventarizim e përgjithshëm vjetor, të aktivitetit.

#### *Në vijimësi*

**9.** Nga auditimi i praktikave për kontrollet e ushtruara në subjektet prodhues të mallrave të akcizës u konstatua se janë ushtruar kontrole pa u kryer më parë **një analizë e plotë rrisht për çdo subjekt**. Kjo analizë duhet të bëhet më parë nga struktura e analizës së rrishtit në degën e doganës dhe më pas të përgatitet Programimi i Kontrollit, i cili miratohet nga autoriteti doganor komplet, mbasi kontrollet e ushtruara në subjektet që administrojnë artikuj akcize janë bërë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSh”, i ndryshuar, neni 45, pika 2; të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. neni 7, pika 1 dhe 2; të VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, neni 67, pika 4. Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 201-213 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës nëpërmjet strukturave të saj, të kryej më parë një analizë të plotë të dokumentuar, për të përcaktuar rrishtin e kontrollit që do të ushtrohet gjatë vitit, për çdo subjekt prodhues të artikujve të akcizës dhe më pas të hartohet Programi Vjetor i Kontrollit, me persona përgjegjës dhe afate konkrete.

#### *Në vijimësi*

**10.** Nga auditimi i dosjeve të subjekteve të akcizës, u konstatua se: DDD nuk ka mbajtur regjistër për regjistrimin e shkeljeve doganore të konstatuara në fushën e akcizës, nuk janë dokumentuar dhe nuk janë pasqyruar rastet e shkeljeve doganore në

fushën e akcizës për çdo subjekt për efekt të historikut të shkeljeve doganore, mbasi historiku i shkeljeve vlen për marrjen e vendimeve administrative në vijimësi për subjektet e prodhimit dhe të tregtimit të artikujve të akcizës, në rastet e konstatuara me shmangie nga verifikimi i pagesave të akcizës, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, neni 86, pika 2 dhe neni 87.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 145-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës të marrë masa të plota për krijimin dhe administrimin e Regjistrimit të shkeljeve doganore në fushën e akcizës i cili duhet të protokollohet dhe të vuloset në çdo faqe, ku të administrohen masat dhe sanksionet e zbatuara për çdo subjekt.

### **Menjëherë**

**11.** *Nga auditimi i procedurave të administrimit të karburanteve në Portin e Lëndëve djegëse në Porto-Romano u konstatua se; sasia e karburanteve të importuara dhe të depozituara në ML përkatëse, nuk merret në dorëzim, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor, sipas përshkrimit të bërë në pikën 4.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, por ajo merret në ngarkim nga administratori i ML-së dhe Sektori i Karburanteve në Porto Romano si diferencë ndemjet matjes së kryera në tokë pas shkarkimit të anijeve dhe matjes së karburanteve gjendje në ML, para shkarkimit të anijeve, në zbatim të kërkesave të vendimit të KM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave të K.D”, i ndryshuar neni 457/1. Nga matjet e kryera kanë rezultuar 1,306,000 litra karburante diferencë në minus dhe në asnjë raste nuk ka rezultuar me plus.*

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 114-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa konkrete për verifikimin dhe rishikimin e procedurave të përcaktuara në vendimin KM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të K.D”, të ndryshuar neni 457/1. mbasi bie ndesh me kërkesat e legjislacionit doganor, për administrimin e mallrave, i cili vazhdon të zbatohet nga Sektori i Karburanteve. Në këto kushte gjykojmë se: për përmirësimin e punës në të ardhmen duhet të rishikohet e gjithë praktika ligjore në fuqi, për administrimin e aktivitetit që ushtrojnë subjektet që administrojnë ML, me qëllim unifikim e e funksionimit të saj në të gjitha portet e lëndëve djegëse në shkallë vendi.

### **Në vijimësi**

**12.** *Nga auditimi i akt rakordimeve të paraqitura nga Sektori i Karburanteve u konstatua se: subjekti “██████████” SHA, me NIPT ██████████, ka eksportuar nëpërmjet deklaratës doganore të eksportit DAV EX-3, me R.- 75615, datë 09.09.2015 nga*

ambiente e ML-01 një sasi 1,813,618 ton Virxhinë Naftë, e cila është ngarkuar në anijen MT "██████" duke e kaluar pronësinë për llogari të subjektit "██████". Sipas kushtit të lëvrimit të përcaktuar në dokumentacionin tregtar dhe doganor të deklaruar. Malli Virxhinë Naftë objekt i deklarimit në DAV-in R-75615, date 09.09.2015 e ngarkuar në anijen MT "██████", që nga kjo periudhë ndodhet jashtë territorit doganor shqiptar. Për këtë veprime nuk janë kryer procedura doganore në Systemin Asycuda, për arsye se subjekti "██████" SHA, me NIPT ██████, në sistemin Assycuda World figuron me status "jo aktiv", i pezulluar në zbatim të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit me DPT, në bazë të shkresën nr. 24877/1, date 03.09.2015, deri në shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

Për të sistemuar këtë diferencë Dega e Doganës Durrës, ka dërguar disa shkresa në Departamentin Operativ Hetimor, Departamentin Teknik, për të krijuar mundësinë e hapjes së monitoruar të NIPT-it të këtij subjekti, me qëllim mbylljen e diferencës në sistem nëpërmjet pranimit të DAV Ex-3 R-75615, datë 09.09.2015, kërkesë e cila ka një dosje të plotë dokumentare, akoma nuk është zgjidhur nga DP, Doganave, që nga muaji shtator deri më 10 mars 2015.

Sa më sipër ,trajtuar më hollësisht në faqet nr. 114-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës të kërkojë bashkëpunim me Ministrinë e Financave, krahas bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të gjetur zgjidhjen ligjore për situatën e krijuar në Sistemin Assykuda World dhe në magazinën e lirë ML-01.

### **Menjëherë**

**13.** Autoriteti doganor kompetent, Dega Doganore Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të ndërtojë dhe krijojë profile risku për mallrat ushqimorë, të cilat për nga emërtimi tregtar klasifikohen në dy ose më shumë kapituj, krerë ose kode tariforë. Për artikuj të klasifikuar në kreun \*2103\* dhe kodin tarifor \*21039090\* dhe për deklarime në kapitullin \*59\* dhe në kreun \*5903\* të kryejë mostrime malli të detyrueshme për Kodin Tarifor \*07032000\* me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor për artikujt e deklaruar në këto kode tariforë. Gjithashtu të informohet personeli përpunues doganor mbi materialitetin e riskut që mbart deklarimi i mallrave që përshkruhen në këto krerë tariforë me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e duhur të detyrimeve doganore që duhen paguar. veprime këto që duhet të kryhen në përputhje me kërkesat e nenit 256 dhe 261. të KD.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-97. të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të vendosë në profile risku krerët e KT \*2103\*, \*5903\* dhe \*07032000\*.

**Në vijimësi**

**14.** *Autoriteti Doganor Kompetent Dega Doganore Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave duhet të nxjerrë dhe të publikojë të dhëna për këto shpenzime transporti origjinë Indi me “Grup Vlerësimi Doganor” duke marrë në konsideratë shpjegimet e udhëzimit nr 25 të Ministrisë të Financave dhe përcaktimet e Kodit Doganor në RSH.*

*Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-97. të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të nxjerrin të dhëna referuese, lidhur me shpenzimet e transportit nga India.

#### **Menjëherë**

**15.** *Autoriteti doganor kompetent Dega Doganore Durrës të kërkojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave verifikimin në vendin dhe kompanitë lëvrues të mallit të dokumentacionit tregtar dhe atij Packing-List të subjektit “█████” dhe “█████” për praktika të evidentuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin Paraprak të Auditimit të protokolluar me shkesën nr 1111/19 datë 26.03.2016 në lidhje detyrimin doganor që duhet të paguanin këto dy subjekte deklarues për taksën e ambalazhit plastik në përmbushje të Udhëzimit nr. 8 datë 30.12.2013 prot DPD “Mbi zbatimin praktik të taksës së ambalazhit” si dhe të garantojë në përputhje me legjislacionin doganor pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjes negative nga Autoritetet Doganore Homologe të Turqisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor*

*Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-97. të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të verifikojë pranë Autoriteteve Doganore Homologe Turke nivelin e saktë të pagesës së taksës së ambalazhit plastik për subjektet “█████” dhe “█████”

#### **Në vijimësi**

**16.** *Autoriteti doganor kompetent Dega Doganore Durrës të kërkojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave verifikimin në vendin dhe kompanitë lëvrues të mallit të subjektit “█████” për praktika të përzgjedhura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin Paraprak të Auditimit të protokolluar me shkesën nr 1111/19 datë 26.03.2016 si dhe të garantojë në përputhje me legjislacionin doganor pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të*



*ardhjes së përgjigjes negative nga Autoritetet Doganore Homologe të Italisë dhe të Spanjës bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor”*

*Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-97. të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të kryejë verifikime pranë Autoriteteve Doganore Homologe të Italisë dhe të Spanjës me qëllim përcaktimin e saktë të vlerës së transaktuar dhe çmimit realisht të paguar nga subjekti “██████████”.

*17. Nga auditimi i ushtruar mbi praktikat doganore në Sektorin e Karburanteve Porto Romano (Magazinat e Lira), u konstatua se janë kryer dalja nga magazina e lirë dhe hyrja në territorin shqiptar e karburantit, të shoqëruar me faturë tatimore me numër serial pa tvsh, me vlerë më të vogël se sa ajo e hyrjes në magazinë nga importuesi i parë. Ky fenomen realizohet nga subjekte (blerësi 1), të cilat blejnë nga importuesi i parë, ulin çmimin dhe i shesin te subjektet (blerësi 2), të cilët e nxjerrin mallin nga regjimi i Magazinave të Lira dhe e hedhin në treg me këtë vlerë të vogël. Megjithëse nga Dega e Doganës Durrës janë vjelë detyrimet doganore mbi bazën e vlerës së importuesit të parë, karburanti që hyn në territorin shqiptar me këto fatura me numër serial me vlerë më të vogël, mund të krijojë kushte që të ulen detyrimet tatimore të mëtejshme që ndjekin shitjen e karburanteve deri të konsumatori final, detyrime që administrohen jo nga administrata doganore por ajo tatimore. Këto subjekte të dyta në këtë zinxhir shit blerjesh janë: “██████████”, me NIPT ██████████; “██████████”, me NIPT ██████████; “██████████”, me NIPT ██████████; “██████████”, me NIPT ██████████; “██████████”, me NIPT ██████████; “██████████” dhe “██████████”.*

*Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 97-114. të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të kërkojë nga **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, që të verifikojë dhe të analizojë situatën e deklarimit të tatimit nga subjektet e dyta të cilat operojnë jashtë regjimit të TVSH-së. Gjithashtu të analizohet dhe verifikohet gjendja e Tatimit të Vlerës së Shtuar që deklarohen subjektet e treta gjatë shitjes së karburantit në territorin shqiptar.

*Në vijimësi*

## **B. MASA ADMINISTRATIVE**

*Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin doganor rezultoi se nga agjencitë doganore, të cilat operojnë pranë Degës së Doganës Durrës, janë trajtuar me MSABE dhe janë keqklasifikuar artikuj me pasojë shmangien e detyrimeve*

doganore, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 261.1; 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë**

1. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit në terren, të marri masa bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, si dhe nenit 41.2 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, për penalitet në masën 50,000 deri në 200,000 lekë, deri në heqjen e e licencës, për agjencitë doganore: “██████” me nr. ██████ “██████” me nr. ██████ me nr. ██████; “██████” me nr. ██████; “██████” me nr. ██████ “██████” me nr. ██████ “██████” me nr. ██████; “██████” me numër ██████ “██████” me nr. ██████ “██████” me nr. ██████ “██████” me nr. ██████; “██████” me nr. ██████ “██████” me nr. ██████

**Menjëherë**

### **C. MASA PER SHPERBLIM DEMI**

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **321,565 mijë lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë

1. Vlera **57,655 mijë lekë**, sipas anekseve nr. 16, trajtuar në faqet nr. 23-64 të RPA, për 34 rastet e shqyrtimit jo si duhet të vlerës doganore të mallrave, gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar të mallrave për subjektin “██████” veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave,

**Deri më 31.10.2016**

2. Vlera **64,528 mijë lekë**, sipas anekseve nr. 4-19, trajtuar në faqet nr. 23-64 të RPA, për trajtimin me origjinë preferenciale të artikujve me deklarata faturë vlera e të cilëve e kalon 6000 euro; keqklasifikimit të artikujve; shqyrtim jo si duhet i vlerës doganore të mallrave dhe gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar të mallrave, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, për rivlerësimin e doganor dhe mos llogaritjen e saktë të detyrimeve, në Sektorin (Sheshin) e Trageteve për vitin, 2015.

**Deri më 31.10.2016**

3. Vlera **10,780 mijë lekë**, sipas anekseve 19-22, trajtuar në faqet 64-75 RPA, për rastet e shqyrtimit jo si duhet të vlerës doganore të mallrave, gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar të mallrave, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave, nga e cila **vlera i përket 2,825 vitit 2014.**

**Deri më 31.10.2016**

**4. Vlera 30,313 mijë lekë,** sipas anekseve 23-41, trajtuar në faqet 75-97 RPA, për raste të keqklasifikimit tarifor të artikujve; shqyrtim e pa saktë të vlerës doganore të mallrave, mospagesës së taksës së akcizës dhe të ambalazhit plastik, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, ligji 61 “Për Akcizat në RSH” në sektorin e kontenierëve, nga e cila **vlera prej 14,647 mijë lekë i përket vitit 2014.**

**Deri më 31.10.2016**

**5. Vlera 2,548 mijë lekë** në 14 raste 43 trajtuar në faqet e nr. 174-176 të RPA, në lidhje me arkiv-protokollin, rezultuan disa shkresa me shkelje në fushën doganore për të cilat nuk është mbajtur procesverbal; apo raste të procesverbaleve të mbajtura për shkelje në fushën doganore, për të cilat autoriteti doganor kompetent nuk ka nxjerr Vendime Administrativ veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor. nenet 285.4, 286, 287.1 dhe 289.1, si më poshtë.

**-8 raste,** në vlerën **645 mijë lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**-2 raste,** në vlerën **1,468 mijë lekë** për subjektin “          ”trajtuar në faqet nr. 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**-4 raste,** në vlerën **435 mijë lekë** nga subjektet për të cilët autoriteti doganor kompetent ka nxjerrë Vendime Administrative, por nuk ka ndjekur rrugët ligjore për rikuperimin e borxhit doganor, *trajtuar në faqet nr 42-44 të RPA.*

**Deri më 31.10.2016**

**6. Vlera 2,600 mijë lekë, nga 13 subjekte** me statusin e magazinës fiskale prodhues dhe tregtues të produkteve të akcizës, sipas **aneksit nr. 1,** bashkëlidhur dhe trajtimit të bërë në faqet 145-154 të këtij RPA, për mos llogaritje të penaliteteve nga DDD në kundërshtim me ligjin nr. 61/2012 datë 05.04.2012 “Për akcizën në RSH” me ndryshime, VKM-në nr. 612, datë 05.09.2012, nenit 85 pika 1/a, nenit 96/1 pika 1, dënohen me gjobë që shkon, deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

**Deri më 31.10.2016**

**7. Vlera 550 mijë lekë,, nga 11 subjekte** me statusin e magazinës fiskale prodhues dhe tregtues të produkteve të akcizës, sipas **aneksit nr. 2,** bashkëlidhur dhe trajtimit të bërë në faqet 145-154 të këtij RPA, për mos llogaritje të penaliteteve nga DDD, në kundërshtim me ligjin nr. 61/2012 datë 05.04.2012 “Për akcizën në RSH” me ndryshime, neni 54, pika 7, neni 65 germa “b” si dhe në bazë të ligjit nr. 8449, date 27.01.1999, “Kodi doganor i RSH” neni 256, paragrafi 2 si dhe neni 275 paragrafi i parë, subjekti penalizohet me 50,000 lekë për çdo rast.

**Deri më 31.10.2016**

**8. Vlera 42,759 mijë lekë**, nga 2 subjekte sipas aneksit nr. 3 trajtuar në faqet...114-138 të RPA, për diferenca rezultuar nga inventarët e kryera, për mos llogaritjen e detyrimeve në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, për vitin, 2015.

**Deri më 31.10.2016**

**9. Vlera 750 mijë lekë**, nga 15 subjekte, trajtuar në faqet nr. 114-138. të RPA, për keq administrim të Regjimit të Përpunimit Aktiv për shkeljen e afateve të mbylljes së autorizimeve, jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret e ligjore, për vitin, 2015.

**Deri më 31.10.2016**

**10. Vlera 2,291 mijë lekë** detyrime doganore të konstatuara gjatë auditimit të Regjimit të Tranzitit, si rezultat i mos mbylljes në sistem të 18 praktikave doganore T1, për vitin 2015.

**Deri më 31.10.2016**

**11. Vlera 52,202 mijë lekë** nga 26 subjekte sipas aneksit nr. 42 trajtuar në faqet 154-174 të PRA, për shkelje të Legjislacionit Doganor sipas ligjit 8449 “Kodi Doganor në RSH”, Ligjit nr 61 “Për Akcizat në RSH” dhe mos llogaritjen e detyrimeve, si dhe për mos arkëtimin e tyre, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e duhura ligjore, për vitin, 2015.

**Deri më 31.10.2016**

**12. Vlera 54,859 mijë lekë** nga 1260 raste sipas anekseve nr. 44-72, trajtuar në faqet nr. 97-114 të RPA, për rivlerësimin e doganor dhe mos llogaritjen e detyrimeve, si dhe për mos arkëtimin e tyre, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e legjislacionit doganor.

**Deri më 31.10.201**

## **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës, Durrës që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 gërma “a”, “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

**a. Neni 58 gërma “ç”, “largim nga shërbimi civil”** për nëpunësin civil.

**1. Për z. I M** me detyrë ish Kryetar,

në Degën e Doganës Durrës, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, si dhe konkretisht:

- për problemet e konstatuara në lidhje me vendimmarrjen jo të duhur ligjore gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative doganore në kundërshtim me Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjin nr. 61 datë 25.08.2012 "*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*",

**b. Neni 58 gërma "b-c", nga "mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj" deri në "largim nga shërbimi civil"** për nëpunësit civil, si më poshtë:

2. Për z. I Ç me detyrë përgjegjës turni;

3. Për z. D D me detyrë ish përgjegjës turni, aktualisht doganier i Anti kontrabandës Detare;

4. Për z. J S me detyrë doganier klasifikim/vlerë;

5. Për z. E P me detyrë doganier klasifikim/vlerë,

6- Për z. Gj M me detyrë përgjegjës turni pranë sektorit Porto Romano

7- Për z. V M me detyrë përgjegjës turni pranë sektorit Porto Romano

8- Për z. V P me detyrë doganier vlerësimi pranë sektorit Porto Romano

9- Për z. A J me detyrë doganier vlerësimi pranë sektorit Porto Romano

për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave "*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*", nxjerrë për këtë qëllim;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklaratë faturë, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 22 të Udhërrëfyesit "*Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale.*", kushtet për lëshimin e një deklarate faturë **citon:** "*Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte orgjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000€*".

- për problemet e konstatuara në lidhje me vendimmarrjen jo të duhur ligjore gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative doganore në kundërshtim me Ligjin nr. 8449

datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 61 datë 25.08.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",

**b. Neni 58 gërma "a-b", nga "vërejtje" deri në "mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj"** për nëpunësit civil, si më poshtë:

10. Për z. EÇ me detyrë doganier klasifikim/vlerë;
11. Për z. R K me detyrë doganier klasifikim/vlerë;
12. Për z. F R me detyrë doganier klasifikim/vlerë;
13. Për z. H M me detyrë përgjegjës i sektorit të anijeve,
14. Për z. B GJ me detyrë jurist
15. Për z. L B me detyrë doganier klasifikim/vlerë

për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave "Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore", nxjerrë për këtë qëllim;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklaratë faturë, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 22 të Udhërrëfyesit "Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale.", kushtet për lëshimin e një deklarate faturë **citon**: "Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një **dërgese** të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, **vlera e të cilave nuk i kalon 6000€...**";

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me sasi tepër deklarimit, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; dhe 261.1 të KD;

- për problemet e konstatuara në lidhje me vendimmarrjen jo të duhur ligjore gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative doganore në kundërshtim me Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 61 datë 25.08.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",

### **Shënim:**

**I. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor per tre ish-punonjës, [REDACTED]**

*II. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 30 punonjës [REDAKTUAR] është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore.*

#### **E. TË TJERA**

Mbi bazën e rekomandimit 17, subjektet: “[REDAKTUAR]”, me NIPT [REDAKTUAR] “[REDAKTUAR]”, me NIPT [REDAKTUAR]; “[REDAKTUAR]”, me NIPT [REDAKTUAR]; “[REDAKTUAR]”, me NIPT [REDAKTUAR]; “[REDAKTUAR]” dhe “[REDAKTUAR]” të dyshuara për shkelje do të përcillen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për një trajtim dhe analizë tatimore më të thelluar.

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar **LESKAJ**

**K R Y E T A R**